



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## Njoftim publik Nr. 05-015/02-87809/22

Drejtoria e Urbanizmit – Komuna e Prishtinës, ka filluar procedurën me numër nr. 05-015/02-87809/22, përmes së cilës kërkohet të emërtohet rruga e cilat gjendet në ZK Prapashticë, Prishtinë.

Agjencia Kadastrale e Kosovës i ka digjitalizuar (si rrugë të re) segmentin e rrugës që shtrihet në këtë hapësirë, ndërsa Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në Neni 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 6, pika 1.2., pika 1.2.1.2., pika 1.2.2. dhe pika 1.2.3., Neni 7, pika 1, pika 2, pika 2.1., 2.2. 2.3. dhe pika 2.4., të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2012 të MMPH – së, i ka dhënë kësaj rruge të re një kod të veçantë (kodi 10830) dhe ka bërë propozimin për emërtim e kësaj rruge.

Emri i propozuar: “GJON MILI”– (1904 – 1984), Mjeshtër i fotografisë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 22.04.2022 deri më 08.05.2022, në E-mail adresën: [urbanizmi@rks-gov.net](mailto:urbanizmi@rks-gov.net)

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2019 të MMPH –së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtim, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal, neni 7, paragrafët 1 dhe 2, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në web-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në web-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë si dhe kodi i rrugës përkatëse.



Nënshkrimi i Zyrtarit: